



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORE

NOTER ANILA HAXHIU
ADRESA Lagjia 29 Nentori, Rruga
Kastriot Muco, Godina 1
TEL: 0696585135

KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

(AKT THEMELIMI I QENDRES)

Nr. repertori: 2509

Nr. koleksioni: 2106

Fier më 14/06/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023062450237258738

*Akti noterial përbëhet nga 9 fletë



A2023062450237258738

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE

"SD3 AGRICULTURE" shpk

Sot, para meje Notere ANILA HAXHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORE, me zyrë në adresën Fier, Lagjia 29 Nentori, Rruga Kastriot Muco, Godina 1, u paraqit personalisht:

ORTAK/ET:

Dule Troka, atësia Udhëtim, amësia Mjaftime, shtetas Shqiptar, lindur në Adë, Fier dhe banues në FIER, me adresë Ade Sheq 01580002; Nd. 19; H. 1; Frakull; Adë; 9313; Fier, lindur më 18/06/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035878670 dhe nr. personal H60618030E,

me cilesine e "Ortakut Themelues ",e angazhuar per te themeluar nje shoqeri te re tregtare ne Shqiperi, dukekuptuarplotesisht Kodin Civil ne fuqi, legjislacionin Shqiptar ne lidhje me shoqerite tregtare (ligjin9901,date 14. 04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "i ndryshuar), si edhe duke patur ne dispozicion te gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idete per te themeluar nje biznes, nepermjet ketij akti,te hartuar dhe nenshkruar ne daten e sotme, shpreh vullnetin dhe angazhimin per te themeluar nje "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ", si vijon:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria "SD3 AGRICULTURE" shpk rregullon poziten e saj juridike, marrëdhëniet e ortakeve,te organeve te saj, llojin e shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, rnarredheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne parashikimet e ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",I ndryshuar dhe neperputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe dispozitat e ketij Statuti.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia,Kohezgjatja,Objekti

Neni1

Emertimi

Emertimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "SD3 AGRICULTURE" Shpk.

Neni2

Forma Juridike

Shoqeria "SD3 AGRICULTURE" shpk eshte person juridik te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria "SD3 AGRICULTURE" shpk, eshte e tille,kapitali i se ciles ndahet ne kuota dhe qe themelohet nga ortaket qe perballojne humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen Njesia Administrative Frakull, Ade, ZK 1001 , Nr pasurie 164/201.



A2023062450237258738

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 4

Objekti

Veprimtaria e shoqërisë është:

- Grumbullim dhe trgtim me pakice dhe shumice fruta perimeve
- Import-Eksport
- Si dhe çdo aktivitet tjetër në fushën e agrocultures që konsiderohet fitimprures dhe në interesat e shoqërisë,
- Shoqëria mund të kryejë çfarë do veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni fuqi I Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Kohezgjatia

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREUI

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 Leke (njëqind mijë leke) ky kapital do të ngurtesohet pasi shoqëria do të regjistrohet në QKB dhe është i përbërë nga 1 (një) kuote, e cila zotërohet si më poshtë:

Ortaku **"Dule Troka - 1** (një) kuote, me vlerë nominale 100.000 Leke, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotes së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdherojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga casti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel të autorizuar, në rast se ka të tillë, të pakten 45 dite përpara datës së mbledhjes së asamblese të thirrur për të marrë vendim rreth



ketij projekti. Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti, e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ose vleren minimale.

Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter.

Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragrafi, cdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise,

Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per temarre vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperem, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene,

Ne rast se shoqeria jep miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vlere te percaktuar sipas rregullave te nenit 11 te ketij ligji.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesv edhe pasardhesve.

KREUIII

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakut te Vetem eshte organi vetem vendimarrës shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetern vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj, Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) percakrimin e shperblimeve per personae e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" të kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulirnin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedimet e tjera ndaj adrnistratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje të tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asarnblene e pergjithshme, ne bazë te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund ce veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asarnblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se



pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese mete njejin rend dite.

Neni10

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret neperrnjete nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim neperrnjete postes elektronike, Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve. jo ml: vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese, Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes L le ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni11

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendirneve, qe kerkojne nje shumice te zakonshrne, asambleja e pergjithshme mund te marre vendirne te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marrë vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane të pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te këtij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorurnit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejin rend dite.

Neni12

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me 3/4 (tri te katertat) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statudit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktirnin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyquar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13

Administrimi

Administratori i pare i shoqeriseeshte **Z. Dule Troka**, , atësia Udhëtim, amësia Mjaftime, shtetas Shqiptar, lindur në Adë, Fier dhe banues në FIER, me adresë Ade Sheq 01580002; Nd. 19; H. 1; Frakull; Adë; 9313; Fier, lindur më 18/06/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035878670 dhe nr. personal H60618030E, i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyreper nje periudhe 3 (tre) vjecare me te drejte ripertesitje.



A2023062450237258738

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë ose zëvendësojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të cdonjerit prejortakeve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- c) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures se veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhëna të detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtime kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 15

Përgjegjësitë



A2023062450237258738

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç së është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë demet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë demet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plote të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga



Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te Jene zbritur humbjete vitit te meparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji.

Neni18

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjenjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtesvendimore qe ka.

Neni 19

Te ardhurat neto

(Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjorete mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimit fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

Neni20

Shperndarjaose prishja e shoqerisemund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- c) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007"Perregjistrimin ebiznesit",i ndryshuar;
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni21

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emerohet me shume se nje likuidues, pervecse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji.

Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posacrne.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjesse ortakut dhe administratorit.

Neni22

Te drejtat e detvrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjithaveprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreveduke



A2023062450237258738

respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te papertfunduar.

3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e ti kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit. Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga ortaket e tjere, ndersa ne shoqerite aksionare apo nga ato me pergjegjesite kufizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Neni23

Perfundimi ilikuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per regjistrimin e biznesit" i ndryshuar.

Neni24

Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njeres ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqerie tjeter ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotaveteshoqerise se re. Ky process quhet bashkim me krijimi nje shoqerie te re.

Neni25

Ndarja

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ka si pasoje:
 - a) kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;
 - b) berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes;
 - c) vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar pa kryerjen e likuidimit.

Neni 26

Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionare





Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtatë detyrime, qe shoqëria ka marrë për sipër ndaj të treqëve

Neni27

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin etij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni28

Mosmarreveshiet

Për mosmarreveshiet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të treqëve, do të jetë kompetente Gjykatata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni29

Dispozitat përfundimtare

Ky statut u redaktua në 2 (dy) ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë tregtare "SD3 AGRICULTURE".

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Une Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gëta përmbajtjen e aktit noterial të mesipër, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Notarinë", vertetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 988", datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", une Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përputtoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKU I VETEM :

ORTAK/ET

Dule Troka

NOTER

ANILA HAXHIU